



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

REKTORATI

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Prizren	
Pranuar më datë 23.01.2018	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-20

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr.prot 01-20
Datë 23.01.2018

Në bazë dispozitive ligjore të nenit 42, 48, 107, 112, dhe nenit 118 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Nr.04-V-621, datë 30 maj 2013, si dhe në zbatim të nenit 18 të rregullores për përcaktimin e studimeve master sipas numrit të referencës 01-184/A dt. 25/05.2015, Senati i Universitetit në mbledhjen e mbajtur më datë 23.01.2018, vendosi dhe nxjerr këtë:

VENDIM

për kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve të nivelit master

- I. Studentët nuk mund t'i nënshtrohen provimeve të vitit të dytë pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të parë.
- II. Për fitimin e statusit të absolventit, duhet që studentët të kenë të përfunduara 50 % të provimeve të vitit të fundit.
- III. Provimet për studimet master mbahen gjatë afatit të provimeve dhe vendoset me vendim të veçantë nga Senati.
- IV. Pas përfundimit të semestrit të fundit të rregullt të studimeve master, studentit do t'i caktohet një periudhë prej 12 muajve për t'i përfunduar provimet (periudha e diplomimit).
- V. Studenti mund të kërkojë edhe një herë nga dekani i njësisë akademike për vazhdimin e periudhës së diplomimit edhe për 12 muaj të tjera.
- VI. Programet e studimeve master përfundojnë me punimin e tezës për master në pajtim me programet e studimeve.
 - Lidhur me studentët të cilët e tejkalojnë kohën e paraparë në lidhje me përfundimin me sukses të diplomimit vlen dispozitivi i pikës VI të këtij vendimi.
 - Studenti i cili e përsërit regjistrimin e vitit të studimeve, paguan tarifën dhe atë të shkollimit.
- VII. Lidhur me lartësinë e pagesave administrative vlejnë dispozitat e "Udhëzimit administrativ (MASHT) mbi aplikimin e pagesave të studentëve në Universitetet publike".
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe do të vlejë deri në një vendim tjetër të kësaj natyre.

Vendimi i dërgohet:

Zyrës së shërbimit të studentëve master,
Dekanit të FE dhe FSHK,
Sekretarit të FE dhe FSHK,
Arkivit të UPZ-së.

Kryesuesi i Senatit

Prof. dr. Ramë Vataj

